



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3064/6 prot

Datë 04.11.2024

V E N D I M
Nr.1545/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:	Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mektrin Motor” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
Ankimues:	“Mektrin Motor” SHPK me K51408501P dhe adresë: Autostrada Durrës - Tiranë, Km 6, Xhafzotaj, Durrës
Autoriteti Kontraktor:	Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë
Subjekt i interesuar:	“Classic” SHPK me NIPT J62009007F dhe adresë Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytesore, godina nr 8 “Albania Motor Company” SHPK me NIPT K41829010I dhe adresë Tirane, Kashar, Mezez, Autostrada Tirane-Durres, km 2, zona kadastrale 2679

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.09.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Përqendruara.

II.2. Në datën 03.10.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 15.10.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. "Classic" SHPK	98,400,000	lekë	skualifikuar
2. "Mektrin Motors" SHPK	106,350,000	lekë	skualifikuar
3. "Albania Motor Company" SHPK	106,500,000	lekë	skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik "Mektrin Motors" sh.p.k rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë:

"OE nuk i përmbush të gjitha specifikimet teknike sic janë kërkuar në DST

Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST dhe konkretisht nuk plotëson pikë 7 "Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknike ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik të autoambulancës, ku të përfshihen specifikimet teknike të automjetit. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT" Katalogu teknik i automjetit i ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga operatori ekonomik nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT. Pikën 8 të "Kapacitetit teknik" "Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent" Operatori ekonomik ka paraqitur Çertifikatën e konformitetit (CoC) në një gjuhë tjetër (italiane) të përcaktuar në DST dhe nuk shoqërohet nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim. Operatori ekonomik ka detyrimin që ofertën si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit ti përgatisë në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Operatori ekonomik skualifikohet për paraqitje dokumentacioni të paplote."

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 16.10.2024 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.10.2024 operatori ekonomik "Mektrin Motors" SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2024/4695, si dhe nr.3064/2024 prot, datë 23.10.2024 me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Mektrin Motor" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë "Classic" SHPK dhe "Albania Motor Company" SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3064/2 prot., datë 24.10.2024.

II.7. Me datë 04.11.2024 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 1354/25 prot., datë 01.11.2024 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e KSHA së autoritetit

kontraktor me nr.1354/24 prot., datë 31.10.2024 protokolluar me tonën me nr. 3064/3 prot., datë 01.11.2024 lidhur me trajtimin e ankesës së ankimesit në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës.

Konkretisht, KSHA në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

II

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE, informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit, procesverbalit të vlerësimit dhe arsyeve të s'kualifikimit

ARSYETON:

II.1. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimes "Mektrin Motors" sh.p.k mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me arsyen e s'kualifikimit të tij se: "Katalogu teknik i automjetëve, ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga operatori Ekonomik, nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT.", KSHA arsyeton se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, "KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT" pika 2.3.6. dhe 2.3.7. është përcaktuar:

"6. Deklaratë ku të citohet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës se kabina e pacientit të autoambulancave do të jetë në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara në shtojcën 5. ,

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge teknike ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik të autoambulancave, ku të përshihen specifikimet teknike të automjetit. Në kataloge duhet të markohen (përfshihen identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT."

Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", parashikohet shprehimisht se: "Autoriteti/enti kontraktor mund t'ua kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si.

- mostra të mallit, kur e gjykon se jo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjën në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose*

- fotografitë apo katalogët teknikë, dhe/ose*

- dëshmi për rezultatet e iesaimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” është përcaktuar: “SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AUTOMJETIT. KATEGORIA E AUTOMJETIT Ambulance, Model A,

Viti i prodhimit të automjetit. 2023-2024

Modeli: 2023-2024

Tipi i motorit. Statusi. Motor Naftë (Diezel

Kapaciteti 2 deri 3 litra

Konsumi i karburantit Max:10 litra/100 km

Emetimi i gazrave. Euro 6-6d

Sistemi i drejtimit : Hidraulik

Numri i dyerve: 4 (kater)

Kambio manuale

Sistemi i drejtimit. Me 4 rrota se nje aks aktiv (4 x2)

2023-2024

Permasal e ambulances.

Gjatesia (mm). min 5900 - max 6120

Lartësia (mm). min 2600 - max 3000

Lartësia e kabines se pacientit(mm). min 1800— max 2100

Gjeresia pa pasqyra “B” (mm) min. 2000 mm

Volumi i karrocierisë min. 11 m’

Pesha mbajtëse min. 1100 kg

Gjatesia e brendeshme e kabines se pacientit (mv). 3250-3550

Fuqia motorrike. min 125 kf

Kapaciteti i serbratorit te naftes. 50 - 75 libra

Transmisioni. manual

Vendi i drejtuesit. Ne te majte

Me kondicioner klimatik. Né kabine e drejtuesit dhe né pjesen e pasme te autoambulances ku asistohet pacienti.

Sisteme elektronike te sigurise.

- ABS — sistemi kundër bllokues i rrotave gjate frenimit
- ASR — sistemi kundër rreshqitjes kendore té rrotave,
- ESP — sislemi i stabilitetit elektronik,
- AIRBAG per shoferin dhe pasagjerin

Xhamai me hapje elektrike

Mbyllje e centralizuar e dyerve dhe komandim ne distance

Sirene bitonale elektornike e inkorporuar me cift fenelinash / Fenelin nje trup Drita anesore dhe adezivet anesor, e kompletuar me modulator.

Antene per frekuenca radio VHF/UHF.

Krik

Xhiro makine

Gome rezerve

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, në përmbushje të specifikimeve teknike të përcaktuar në Shtojcën 5 të Dokumenteve të Tenderit, operatori ekonomik ankimes "Mektrin Motorrs" shpik ka paraqitur:

1. Certifikatë Konformiteti CE (3701190002498) Nr. Barcode 2023-VHS-000891819 datë 17.07.2023, ku evidentohen të dhënat si më poshtë:

Viti i prodhimit	17.07.2023;
Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra:	2179 cm ³ - 2.2 litra
Karburanti	Naftë
Konsumi i kombinuar i karburantit: 9.6 litra / 100 km	
Emetimi i gazrave: Euro 6 — AR	

Numri i dymve: 2 - para në pjesët anësore
1 - mbrapa në pjesën anësore

Kambio: manual 6+R
Sistemi i drejtimit: 2-akse

Modeli i kabinës (mm): BB — Furgon i Bardhë 4035 mm
Ngjyra e bardhe
Gjatësia ndërmjet akseve (mm): 4035 mm
Gjerësia (mm) 2050 mm
Gjatësia (mm): 5998 mm
Lartësia (mm): 2760 mm
Gjatësia e brëndëshme e kabinës së pacientit (mm):
3705 mm
Pesha mbajtëse maksimale teknike: 3500 kg

2. Dokumenti me emërtimin “Kaialog_A utomjeti FIAT DUCA TO”, ku evidentohen specifikimet teknike si më poshtë:

Tipi i motorit:

(faqe 24)

- MultiJet 3, 140 HP (140 kuaj fuqi);
- Numri i cilindrave, 4 cilindra, në linjë, dizajn industrial;
- Fuqia (kW/HP): 140 HP, (104 kW) në 3500 rpm, transmetues manual 350 Nm në 1400 rpm;
- Light Duty, niveli i emetimit: Euro 6D-Finalja;
- Heavy Duty, niveli i emetimit: Euro VI hapi E;

Statusi: ± zero Km
Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra: 2184 cm³ - 2.2 litra (faqe 24)

Emetimi i gazrave:	Euro 6D	(faqe 24)
Sistemi i drejtimit	Elektrik	(faqe 10)
Numri i dyerve:	4(katër)	(faqe 33)
Kambio:	Manuale	(faqe 24)
Sistemi i drejtimit	2 Akse — 4 Rrota	(faqe 29)

Përmasat e ambulancës:

Gjatësia ndërmjet akseve (mm):	4035 mm	(faqe 29)
Gjatësia(mm):	5998 mm	(faqe 29)
Lartësia(mm):	2760 mm	(faqe 29)
Lartësia e kabinës së pacientit (mm) :	1932 mm	(faqe 33)
Gjatësia e brëndëshme e kabinës së pacientit (mm):	3705 mm	(faqe 33)
Gjerësia e kabinës së pacientit (mm)	1870 mm	(faqe 33)
Volumi i karrocërisë	13 m ³ dhe 15 m ³	(faqe 33)
Pesha mbajtëse	1390 - 2150 kg;	(faqe 29)
Fuqia motorrike:	140 kf(HP)	(faqe 24)
Transmisioni:	manual	(faqe 24)

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, paj isjet e asete të tjeia fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, g ithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me kontratën objekt prokurimi, jo vetëm në natyrë por edhe në përbërje të saj, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE prej operatorit ekonomik ankimues "Mektrin Motorrs" shpk konstatohet se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka dorëzuar "Katalog Automjeti FIAT DUCATO", ku evidentohen specifikimet teknike sipas kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 5 të Dokumenteve të Tenderit. Lehtësisht i dallueshëm është tipi i motorrit MultiJet 3, 140 HP (140 kuaj fuqi), 2.2 litra (2184 cm"), Kambio Martiale, Euro 6D, Naftë (faqe 24). Në faqen 29 përcaktohen konfigurimet e prodhuesit për automjetin FIAT DUCATO ku evidentohet konfigurimi që plotëson specifikimet teknike, konfigurimi me distancën midis akseve 4035 mm ose HAPI 4035 mm. Sa i takon specifikimeve teknike lidhur me dimensionet e kabinës së pacientit, lehtësisht të evidentueshme janë paraqitur në faqen 33, HAPI 4035 mm. Gjithashtu, katalogu përmban edhe të gjithë informacionin lidhur me dizajnin e brendshëm të automjetit, sistemet e sigurisë në qarkullim, sistemet audio, navigator, kondicionim, keyless lock, ndricim i jashtëm apo i brendshëm dhe çdo detaj tjetër teknik për një automjet që i takon vitit të prodhimit 2023. Akoma më tej, informacion i detajuar lidhur me specifikimet teknike të automjetit paraqitet edhe në dokumentin "Certifikatë Konformiteti CE (3701190002498)

Nr. Barcode 2023- VHS- 000891819 datë 17.07.2023”, dokument ky i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në SPE.

Nga ana e operatorit ekonomik ankimues, lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike të sipercituara është paraqitur edhe një Deklaratë ku citohet se “Mektrin **Motors deklar**on se kabina e pacientit të autoambulancave dote jetë në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve **teknike** të kërkuara në **shtojcën 5**”.

Referuar së më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se operatori ekonomik ankimues “Mektrin Motors”, me dokumentacionin e dorëzuar plotëson kriterin e sipercituar në pikën 2.3.7. si dhe oferta e paraqitur prej tij plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcëri 5 të DT.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MEKTRIN MOTORS” sh.p.k mbt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës s’e tij: “përsa i takon gjuhës së certifikates së konformifetoit (CoC)”, KSHA arsyeton se:

Në kriteret e vecanta të kualifikimit të Dokumentave të Tenderit, pika 8, “Kapaciteti teknik”, është përcaktuar se: “Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent”

Në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 parashikohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorit ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën **sipas** një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore në vecanti mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”.

Referuar, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, pika 2, parashikohet shprehimisht se: “Për mallrai që do të okurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajrë minimumin oseteresinee etementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me neein 36, të **LPP-së**, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshine për funksionet e kërkuara”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me kontratën objekt prokurimi, jo vetëm në natyrë por edhe në përbërje të saj, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentet e paraqitura në sistemin e prokurimit elektronik, argumentimet e pretendimit të operatorit ekonomik ankimues si dhe kriterin specifik konkludon se në përmbajtjen e këtij kriteri dokumenti i kërkuar është deklarata nga operatori ekonomik që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Evropian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE-së st dhe kjo deklaratë shoqëruar me Certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent. KSHA konstaton se në sistemin e prokurimit elektronik është paraqitur deklarata nga operatori ekonomik ankimues "MEKTRIN MOTORS" shpk sipas së cilës deklarohet konformiteti i kërkuar për mjetin. Gjithashtu si pjesë mbështetëse e kësaj deklarata është paraqitur edhe certifikata e konformitetit (CoC) në versionin origjinal, e lëshuar nga prodhuesi.

Përsa i përket arsyes së s'kualifikimit se ky dokument duhet të ishte i përkthyer në gjuhën shqipe, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se procedura e prokurimit me objekt Loti 4: "Blerje Autoambulanca për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" është një procedurë "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" dhe gjuha e përdorur nuk është vetëm shqip. Dokumenti Certifikatë konformiteti (CoC) është një dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi i një automjeti, që qe konfirmon se automjeti plotëson kërkesat teknike e percaktuara nga Bashkimi Europian duke përbërë një formë tip i cili përmban elementet dhe të dhëna teknike të universalizuara. KSHA konstaton se këto të dhëna teknike të përfshira në kütü 5ert ifikatë përshkruhen si pas kërkesave të dokumenteve të tenderit lidhur me specifikimet teknike dhe katalogun teknik të dorëzuar nga operatori ekonomik MEKTRIN MOTORS" shpk.. Këto kërkesa gjykohen në funksion të njera tjetres dhe në teresi rezultojnë plotësimi i të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DT.

Referuar ligjit nr. 8378, datë 22.07. 1998 "Kodi Rrëgullor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-së nr. 1.53, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.04, datë 28.06.2019 "Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore" për regjistrimin e mjeteve në Republikën e Shqipërisë është e nevojshme Certifikata e Konformitetit (CoC), në versionin origjinal..

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në datë 25.10.2024 i dërgoi një kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nëpërmjet shkresës nr. 1976 prot ku kërkoi informacion lidhur me mënyrën e paraqitjes (formati, gjuha e pranuar, elementët përmbajtësor) në rastet e Certifikatave të lëshuara nga vende të Bashkimit Evropian dhe ato jashtë tij. Në shkresën nr. 1976/ 1 prot, datë 31.10.2024 dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor ku citohet shprehimisht se : "dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja duhet të jetë certifikata e përputhjes ose dokumenti me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit të lëshuar nga prodhuesi në origjinal"

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, komisioni i shqyrtimit të ankesës,

VENDOSI

- 1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” sh.p.k*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorit ekonomik të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.*

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të *lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mektrin Motors” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit, dhe lenien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “Classic” SHPK dhe “Albania Motor Company” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me datë 04.11.2024 autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr. 1354/25 prot., datë 01.11.2024 ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor me nr.1354/24 prot., datë 31.10.2024 protokolluar me tonën me nr. 3064/3 prot., datë 01.11.2024 lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesit në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës.

Konkretisht, KSHA në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

II

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE, informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit, procesverbalit të vlerësimit dhe arsyeve të s'kualifikimit

ARSYETON:

II.1. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Mektrin Motors” sh.p.k mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me arsyen e skualifikimit të tij se: “Katalogu telmik i aulomjeiii, ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga operatori Ekonomik, nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT.”, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” pika 2.3.6. dhe 2.3.7. është përcaktuar:

“6. Deklaratë ku të citohet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës se kabina e pacientit të autoambulancave do të jetë në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara në shtojcën 5. ,

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge teknike ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik të autoambulancave, ku të përshihen specifikimet teknike të automjetit. Në kataloge duhet të markohen (pe lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT.”

Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si.

- mostra të mallit, kur e gjykon se jo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjën në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalët mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose*
- fotografitë apo katalogët teknikë, dhe/ose*
- dëshmi për rezultatet e ivesimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” është përcaktuar: “SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AUTOMJETIT. KATEGORIA E AUTOMJETIT Ambulance, Model A,

Viti i prodhimit të automjetit. 2023-2024

Modeli: 2023-2024

Tipi i motorit. Statusi. ' Motor Naftë (Diezel

Kapaciteti 2 deri 3 litra

Konsumi i karburantit Max:10 litra/100 km

Emetimi i gazrave. Euro 6-6d

Sistemi i drejtimit : Hidraulik

Numri i dyerve: 4 (kater)

Kambio manuale

Sistemi i drejtimit. Me 4 rrota se nje aks aktiv (4 x2)

2023-2024

Permasal e ambulances.

Gjatesia (mm). ' min 5900 - max 6120

Lartësia (mm). min 2600 - max 3000

Lartësia e kabines se pacientit(mm) . min 1800— max 2100

Gjeresia pa pasqyra "B" (mm) min. 2000 mm

Volumi i karrocierisë min. 11 m'

Pesha mbajtëse min. 1100 kg

Gjatesia e brendeshme e kabines se pacientit (mv). 3250-3550

Fuqia motorrike. min 125 kf

Kapaciteti i serbratorit te naftes. 50 - 75 libra

Transmisioni. manual

Vendi i drejtuesit. Ne te majte

Me kondicioner klimatik. Né kabine e drejtuesit dhe né pjesen e pasme te autoambulances ku asistohet pacienti.

Sisteme elektronike te sigurise.

- ABS — sistemi kundër bllokues i rrotave gjate frenimit
- ASR — sistemi kundër rreshqitjes kendore të rrotave,
- ESP — sislemi i stabilitetit elektronik,
- AIRBAG per shoferin dhe pasagjerin

Xhamai me hapje elektrike

Mbyllje e centralizuar e dyerve dhe komandim ne distance

Sirene bitonale elektornike e inkorporuar me cift fenelinash / Fenelin nje trup Drita anesore dhe adezivet anesor, e kompletuar me modulator.

Antene per frekuenca radio VHF/UHF.

Krik

Xhiro makine

Gome rezerve

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, në përmbushje të specifikimeve teknike të përcaktuar në Shtojcën 5 të Dokumenteve të Tenderit, operatori ekonomik ankimes "Mektrin Motorrs" shpk ka paraqitur:

2. *Certifikatë Konformiteti CE (3701190002498) Nr. Barcode 2023-VHS-000891819 datë 17.07.2023, ku evidentohen të dhënat si më poshtë:*

Viti i prodhimit	17.07.2023;
Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra:	2179 cm ³ - 2.2 litra
Karburanti	Naftë
Konsumi i kombinuar i karburantit: 9.6 litra / 100 km	
Emetimi i gazrave: Euro 6 — AR	

Numri i dyerve: 2 - para në pjesët anësore
1 - mbrapa në pjesën anësore

Kambio: manual 6+R
Sistemi i drejtimit: 2-akse

Modeli i kabinës (mm): BB — Furgon i Bardhë 4035 mm
Ngjyra e bardhe
Gjatësia ndërmjet akseve (mm): 4035 mm
Gjerësia (mm) 2050 mm
Gjatësia (mm): 5998 mm
Lartësia (mm): 2760 mm
Gjatësia e brëndëshme e kabinës së pacientit (mm):
3705 mm
Pesha mbajtëse maksimale teknike: 3500 kg

2. Dokumenti me emërtimin “Kaialog_A utomjeti FIAT DUCA TO”, ku evidentohen specifikimet teknike si më poshtë:

Tipi i motorit:

(faqe 24)

-MultiJet 3, 140 HP (140 kuaj fuqi);
-Numri i cilindrave, 4 cilindra, në linjë, dizajn industrial;
-F uqia (kf/HP): 140 HP, (104 kE) në 3500 rpm, transmetues manual 350 Nm në 1400 rpm;
-Light Duty, niveli i emetimit: Euro 6D-Finalja;
-Heavy Duty, niveli i emetimit: Euro VI hapi E;

Statusi:		± zero Km
Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra:	2184 cm ³ - 2.2 litra	(faqe 24)
Emetimi i gazrave:	Euro 6D	(faqe 24)
Sistemi i drejtimit	Elektrik	(faqe 10)
Numri i dyerve:	4(katër)	(faqe 33)
Kambio:	Manuale	(faqe 24)
Sistemi i drejtimit	2 Akse — 4 Rrota	(faqe 29)

Përmasat e ambulancës:

<i>Gjatësia ndërmjet akseve (mm):</i>	4035 mm	(faqe 29)
<i>Gjatësia(mm):</i>	5998 mm	(faqe 29)
<i>Lartësia(mm):</i>	2760 mm	(faqe 29)
<i>Lartësia e kabinës së pacientit (mm) :</i>	1932 mm	(faqe 33)
<i>Gjatësia e brëndëshme e kabinës së pacientit (mm):</i>	3705 mm	(faqe 33)
<i>Gjerësia e kabinës së pacientit (mm)</i>	1870 mm	(faqe 33)
<i>Volumi i karrocërisë</i>	13 m ³ dhe 15 m ³	(faqe 33)
<i>Pesha mbajtëse</i>	1390 - 2150 kg;	(faqe 29)
<i>Fuqia motorrike:</i>	140 kf(HP)	(faqe 24)
<i>Transmisioni:</i>	manual	(faqe 24)

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, paj isjet e asete të tjeia fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, g ithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me kontratën objekt prokurimi, jo vetëm në natyrë por edhe në përbërje të saj, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE prej operatorit ekonomik ankimues “Mektrin Motorrs” shpk konstatohet se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka dorëzuar “Katalog Automjeti FIAT DUCATO”, ku evidentohen specifikimet teknike sipas kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 5 të Dokumenteve të Tenderit. Lehtësisht i dallueshëm është tipi i motorrit MultiJet 3, 140 HP (140 kuaj fuqi), 2.2 litra (2184 cm³), Kambio Martiale, Euro 6D, Naftë (faqe 24). Në faqen 29 përcaktohen konfigurimet e prodhuesit për automjetin FIAT DUCATO ku evidentohet konfigurimi që plotëson specifikimet teknike, konfigurimi me distancën midis akseve 4035 mm ose HAPI 4035 mm. Sa i takon specifikimeve teknike lidhur me dimensionet e kabinës së pacientit, lehtësisht të evidentueshme janë paraqitur në faqen 33, HAPI 4035 mm. Gjithashtu, katalogu përmban edhe të gjithë informacionin lidhur me dizajnin e brendshëm të automjetit, sistemet e sigurisë në qarkullim, sistemet audio, navigator, kondicionim, keyless lock, ndricim i jashtëm apo i brendshëm dhe çdo detaj tjetër teknik për një automjet që i takon vitit të prodhimit 2023. Akoma më tej, informacion i detajuar lidhur me specifikimet teknike të automjetit paraqitet edhe në dokumentin “Certifikatë Konformiteti CE (3701190002498) Nr. Barcode 2023- VHS- 000891819 datë 17.07.2023”, dokument ky i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në SPE.

Nga ana e operatorit ekonomik ankimues, lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike të sipërcituara është paraqitur edhe një Deklaratë ku citohet se “Mektrin Motors deklaroi se

kabina e pacientit të autoambulancave dote jetë në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve **teknike** të kërkuara në **shtojcën 5**”.

Referuar së më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se operatori ekonomik ankimues “Mektrin Motors”, me dokumentacionin e dorëzuar plotëson kriterin e sipërcituar në pikën 2.3.7. si dhe oferta e paraqitur prej tij plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcëri 5 të DT.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MEKTRIN MOTORS” sh.p.k mbt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës s’e tij: “përsa i takon gjuhës së certifikates së konformifetoit (CoC)”, KSHA arsyeton se:

Në kriteret e vecanta të kualifikimit të Dokumentave të Tenderit, pika 8, “Kapaciteti teknik”, është përcaktuar se: “Operatori ekonomik duhet te deklaroje që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit European ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent”

Në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 parashikohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorit ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbaluar kontratën **sipas** një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore në vecanti mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”.

Referuar, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, pika 2, parashikohet shprehimisht se: “Për mallrai që do të okurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajrië minimumin oseteresinee etementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me neein 36, të **LPP-së**, dhe që i vlerëson mallrat st të pranueshine për funksionet e kërkuara”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të opetatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kua1ifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me kontratën objekt

prokurimi, jo vetëm në natyrë por edhe në përbërje të saj, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentet e paraqitura në sistemin e prokurimit elektronik, argumentimet e pretendimit të operatorit ekonomik ankimues si dhe kriterin specifik konkludon se në përmbajtjen e këtij kriteri dokumenti i kërkuar është deklarata nga operatori ekonomik që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Evropian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE-së si dhe kjo deklaratë shoqëruar me Certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent. KSHA konstaton se në sistemin e prokurimit elektronik është paraqitur deklarata nga operatori ekonomik ankimues "MEKTRIN MOTORS" shpk sipas së cilës deklarohet konformiteti i kërkuar për mjetin. Gjithashtu si pjesë mbështetëse e kësaj deklarate është paraqitur edhe certifikata e konformitetit (CoC) në versionin origjinal, e lëshuar nga prodhuesi.

Persa i përket arsyes së s'kualifikimit se ky dokument duhet të ishte i përkthyer në gjuhën shqipe, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se procedura e prokurimit me objekt Loti 4: "Blerje Autoambulanca për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" është një procedurë "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" dhe gjuha e përdorur nuk është vetëm shqip. Dokumenti Certifikatë konformiteti (CoC) është një dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi i një automjeti, që qe konfirmon se automjeti plotëson kërkesat teknike e percaktuara nga Bashkimi Europian duke përbërë një formë tip të cili përmban elementet dhe të dhëna teknike të universalizuara. KSHA konstaton se këto të dhëna teknike të përfshira në kütü 5ert ifikatë përshkruhen si pas kërkesave të dokumenteve të tenderit lidhur me specifikimet teknike dhe katalogun teknik të dorëzuar nga operatori ekonomik MEKTRIN MOTORS" shpk.. Këto kërkesa gjykohen në funksion të njera tjetres dhe në tërësi rezultojnë plotësimi i të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DT.

Referuar ligjit nr. 8378, datë 22.07. 1998 "Kodi Rrëgor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-së nr. 1.53, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.04, datë 28.06.2019 "Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore" për regjistrimin e mjeteve në Republikën e Shqipërisë është e nevojshme Certifikata e Konformitetit (CoC), në versionin origjinal..

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në datë 25.10.2024 i dërgoi një kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nëpërmjet shkresës nr. 1976 prot ku kërkoi informacion lidhur me mënyrën e paraqitjes (formati, gjuha e pranuar, elementët përmbajtësor) në rastet e Certifikatave të lëshuara nga vende të Bashkimit Evropian dhe ato jashtë tij. Në shkresën nr. 1976/ 1 prot, datë 31.10.2024 dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor ku citohet shprehimisht se : "dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja duhet të jetë certifikata e përputhjes ose dokumenti me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit të lëshuar nga prodhuesi në origjinal"

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, komisioni i shqyrtimit të ankesës,

VENDOSI

1. *Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” sh.p.k*
2. *Personi përgjegjës për prokuri imin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
3. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorit ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
4. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
5. *Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.*

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-18801-09-11-2024, me objekt: “Loti 4: “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 108,518,288.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr.1354/24 prot., datë 31.10.2024 ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike me datë 04.11.2024 përmes shkresës nr.13254/25prot., datë 01.11.2024 protokolluar me tonën me nr. 3064/3 prot., datë 04.11.2024.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mektrin Motors” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

